



Kurora e Gjelbër

Botim i Shoqatës Kombëtare të Pyjeve Komunalë, Tiranë (Viti i dhjetë i botimit) Nr. 70 prill 2007 Çmimi 20 lekë

SEMINAR NDERKOMBETAR

“Shkëmbimi i eksperiencës dhe dijeve në përgatitjen e hartave me pjesëmarrje - Kombinimi i teknikave të ndryshme në përgatitjen e hartave për të adresuar politika dhe sfida në menaxhimin dhe përdorimin e tokave pyjore e kullosore”

Nga data 27 - 31 maj të këtij viti në Hotel Rogner (Tirana europark), në këtë seminar, organizuar nga Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale të Shqipërisë, me mbështetjen financiare të Aleancës Ndërkombëtare për Tokën, do të përftohet nga eksperiencat e Shqipërisë, Nikaraguas, Indonezisë dhe Bolivisë. Seminari do t’u krijojë mundësi pjesëmarrësve të kenë njohuri të përgjithshme mbi metodat dhe aplikimet e hartografisë me pjesëmarrje. Në seminar do të ftohen për të marrë pjesë edhe institucionet kryesore që lidhen me pyjet e kullotat komunale, donatorët kryesorë, si dhe përfaqësues të shoqatave të pronarëve privatë të Pyjeve nga Kosova e Maqedonia.

Seminari ka këto objektiva kryesore:


- Shkëmbim i dijeve midis pjesëmarrësve në praktikat dhe metodologjitë për të fiksuar në harta të drejtat e përdorimit në zonat rurale, me fokus specifik në pyje e kullota.
- Rritjen e të kuptuarit të sfidave metodologjike në raport me kontekstin e politikave që mbështesin njohjen e të drejtave të përdorimit, në mënyrë që të shtohen e mbështeten zgjidhjet lokale novatore në përgatitjen e hartave për të drejtat e përdorimit me referenca të veçanta në kontekstin shqiptar.
- Kontribut në debatin ndërkombëtar në potencialet e hartografisë dhe hartave, si mjet për regjistrimin e të drejtave të përdorimit.

Procesi i transferimit dhe decentrelazimit të menaxhimit të pyjeve e kullotave komunale në Shqipëri

Që në vitin 1995, Qeveria e Shqipërisë, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe donatorëve të tjerë, bazuar në politikat për transferimin e burimeve natyrore njësisve të qeverisjes vendore, ka mbështetur transferimin e të drejtave të përdorimit nga shteti tek bashkësitë lokale. Ky përaftrim i ri në menaxhimin e burimeve natyrore filloi për të frenuar degradimin e burimeve natyrore në një sipërfaqe prej mbi 500 mijë ha pyje e kullota. Eksperiencia nga ky proces ka treguar që zbutja e varfërisë dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore mund të ecin paralelisht kur komunitetet mbështeten në të drejtat për të menaxhuar pyllin e përfituar prej tij. Shoqatat e ngritura në komuna kanë zhvilluar e zbatuar plane menaxhimi për përmirësimin e këtyre burimeve.

Shoqatat janë organizuar pas vitit 2002 në federata rajonale dhe në vitin 2004 federatat rajonale të Dibresë, Kukësit e Korçës u mblodhën dhe kërkuan të përfaqësohen në shkallë kombëtare, gjë që u realizua juridikisht në vitin 2005. Në kuadër të mbështetjes së shoqatave dhe federative rajonale, SHKPPK, e financuar nga Aleanca Ndërkombëtare e Tokës, po realizon projektin “Rritja e sigurisë së pronësisë nëpërmjet mbështetjes së komuniteteve për të përmirësuar kuadrin ligjor në transferimin e pyjeve dhe kullotave”. Projekti synon të shtojë sigurinë mbi pronësinë dhe të drejtat e përdorimit në përputhje me traditat e çdo fshati apo krahine të vendit.

Libra të rinj



Faqe 4, 5



Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë pylli dhe në shkurre bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e njësisve të qeverisjes vendore, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

Organet e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe me strukturat e shërbimit për mbrojtjen nga zjarri dhe të shpëtimit, organizojnë punën për parandalimin e zjarrit në fondin pyjor kombëtar.

Nga Ligji Nr. 9385, dt. 4.5.2005

Nga Konferenca Ndërkombëtare e mbajtur në Sofie të Bullgarisë

Zhvillimi i strategjive rajonale për bashkëpunim ndërkombëtar në menaxhimin e zjarreve në pyje

nga GENCIOXHAJ
Specialist në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit për Policinë Pyjore, Tiranë

Faqe 3

GORA KËRKON PYLLIN

nga HAKI KOLA

Faqe 2, 7



nga Prof.As. Dr. AHMET OSJA

KOPLIKIU, QENDRA E NJË TREVE TË PASUR NË HISTORIE TRADITË

Faqe 5

HAPA KONKRET NË ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË PYJVE E KULLOTAVE

Ing. VLASHLEGISI
Shef i seksionit të Aministrit-Menaxhimit në DSHP Mirditë

Faqe 2, 3



Koalicioni Ndërkombëtar i Tokës është një aleancë globale ndërqeveritare, qeveritare dhe e organizatave të shoqërisë civile. Koalicioni punon së bashku me të varfërit e zonave rurale, për të rritur dhe për të siguruar arritshmëri tek burimet natyrore, veçanërisht tek toka dhe për t'i mundësuar ata të marrin pjesë direkt në proceset e hartimit të politikave dhe të vendimmarrjes, që ndikojnë në jetesën e tyre në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

GORA KËRKON PYLLIN

nga HAKIKOLA



Funddhjetori 2006 ishte vërtet i veçantë, pa borë e akull, pa shi e mjegull. Si në verë; mund të niseshe për udhëtim në 5 të mengjesit e të ktheheshe në 10 të darkës, duke kaluar Qafën e Thanës e Grykën e Devollit për në Gorë. Gora, një malësi midis Mokrës në veri, fushën e Korçës në juglindje, me malin e Lenies në Lindje e Voskopojën në perëndim, e gjatë veri-jug 28 km dhe e gjerë lindje-perëndim 18 km, me amplitude lartësie nga fundi i luginës deri në majëmale prej rreth 1000 m, na pret për të na kërkuar pyllin. Do të kalosh vende që presin verën e ardhshme për të parë diellin e aty do të duhet pak kujdes se mos makina rrëshqet në brymë. Një ndryshim klime i paparë dhe, ndërsa shkojmë në takimin në kuadër të hartimit të planit të zhvillimit të pyjeve e kullotave të komunës së Gorës, duket se ky ndryshim radikal i klimës, kjo mungesë e tejskajshme e ujërave, është një thirrje që na bëhet nga burimet natyrore, për t'i marrë në konsideratë e ruajtur nga shkretimi.

Kryetari i komunës, Fidaiu, duket që ka nevojë që shqetësimin e banorëve ta ndajë me specialistë, si nga Ministria ashtu edhe nga Fakulteti e Instituti i Shkencave Pyjore apo Shoqata Kombetare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale. Të ftuarit janë të shumtë dhe atyre të Tiranës u bashkohet edhe një grup specialistësh nga Berati, që ndoshta duan të marrin në Gorë një shqetësim për ta përdorur për të njohur Beratin. Ndërsa zbresim në sheshin para zyrave të komunës, mësojme se gjashte fshatra të Gorës e kanë non stop energjinë elektrike, të cilën e prodhojnë nga një hidrocentral me ujë vendi rreth 200 m më poshtë, në anë të lumit. Është i pari vend që ka energji në këtë orë nga ajo që ne pame në rrugën nga Tirana e gjer në Gorë.

Në fjalën e hapjes, Fidaiu kërkoi ndjesë që kanë ftuar vetëm një përfaqësues për fshat. Kjo për faktin se Gora ka mbi 18 fshatra dhe të besh një mbledhje pune me më shumë se 30-40 veta bëhet e vështirë. Mbledhje të hapura janë bërë në çdo fshat,

por veçanërisht këshilltarët e fshatrave, dëshirën e kishin të flisnin me këdo të Ministrisë e t'ua thoshin edhe njëherë hallet. Reizi i Strelcës ka folur edhe në emisionin e Arian Çanit, ka shkruar edhe në gazeta për Rrobullin, por jemi në fshat e kemi nevojë që dikush të na dëgjojë. Përfaqësuesit e fshatrave shprehin me fjalë të ndryshme të gjithë një shqetësim, deri në alarm: Si mund të arrihet që të ndalohet prerja dhe shkatërrimi i pyjeve? Nuk grinden, por vetëm debatojnë e argumentojnë. Me menyra të ndryshme, ata shprehin se nuk duan t'i marrin gjë shtetit, nëse kërkohet që ta ruajnë pyllin që ndodhet historikisht në kufijtë tradicionalë të tyre e duan që ta shpëtojnë. Shtetin dhe sherbimin pyjor kërkohet që ti kene në krahë, pasi me nevojën e madhe që ka fusha e Korçës për dru zjarri, u duket vetja shumë pak e të pamundur për të ndaluar prerjet. Goranët janë vërtet shumë të shqetësuar; ata janë tejet të interesuar që të rregullohet ligji i pyjeve. Këtë nuk e kërkohet për t'u bërë të pasur, e kërkohet që të shpëtojnë nga shkretimi.

Ndërsa pyesim njëri-tjetrin se çfarë kërkon Prof. Spiro Karadumi në Gorë, pasi ai ka realisht përvojë dhe është ndër inxhinierët që e njeh më së miri Beratin, ku ka filluar karrierën. Mëndja të shkon më larg. Ndoshta Gora për nga bimësia pyjore paraqet një situatë që në kodrat e Vokopoles, Terpanit, apo në të gjitha kodrat e zhveshura për gjatë luginës së Tomoricës, të kodrave nga Berati deri në Skrapar nga njëra anë, apo gjer në Buz të Tepelenës nga ana tjetër, ka qenë 3-4 shekuj më parë. Megjithë shpresën që kanë në faktin se natyra fal dhe sheron plagët, duhet të jesh më tepër se optimist të besosh se mund të

prishësh pamjen e shkretëtirës si fazë perfundimtare e shkatërrimit dhe varferimit të tokës ... nga ku prodhohen valet e shtangura të rërës, që uji e era i përcjellin të mbushin shtretit e përrejt fare të thatë në verë e shumë agresivë në dimër. Tek ke marrë detyren të bësh një marrëveshje e të ndalosh degradimin e mëtejshëm e të fillosh suksesionin pozitiv të bimësisë, duhet të gjesh edhe shkaqet që e kanë katandisur në këtë ditë tokën. Gabojnë kur thone se shkretimin në disa zona e ka sjelle lufta, në fakt shkatërrimin e sjell edhe padija e drejtimi i njëanshëm në veprimet tona, kokëfortësia për t'i marrë shpatit të malit atë që nuk mund të ta japë. Zeri i fshatarëve të Gorës duket si analizë serioze e parathenies se shkretëtirës, diskutojnë me njëri-tjetrin Prof. Thimaqi me Arsenin.

Tek sheh Gorën dhe përpjekjet që bëjnë banorët për të shpëtuar çfarë të mundin, fillimisht alarmohesh e thua se këta malësorë të urtë dikush i nxit, që të marrin pyjet e të bëhen pronarë, ashtu siç morën fshatarët e fushës së Korçës apo të Myzeqesë tokën e tyre. Njëri pas tjetrit, ata ngrihen e thonë se duan përkrahjen e ligjit për të mbrojtur atë copë pylli që u takon. Nëse policia e shtetit dënon me burg dikë që mbjell një bimë Canabis, atëherë si është e mundur që kur priten male të tëra askush nuk dënohet dhe policia asqë shqetësohet, thotë Maks Kodra. Ne nuk kemi fushë, nuk kemi asnjë fabrikë, minierat janë mbyllur, makina që punon tek ne, është uji që na jep drite dhe pylli i Gorës. Pylli është një nga makinat më të vjetra, që prodhon edhe ujin, por nëse nuk ndalohet shkatërrimi, është makine tepër e vështirë, ndoshta më e vështira për t'u meremetuar. Ne e dimë se është e domosdoshme të vëmë një farë rregulli, sikur e presim ashtu edhe kur e kullosim. Këtë rregull na e lanë të parët, megjithë fukarallekun e padijen. Të gjithë njëzëri thonë se Strelcës e Lozhanit u duhet kthyer mali, që nga buza

Vijon në fq. 7

HAPA KONKRET NË ARRITJEN E OBJEKTIVAVE TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË PYJVE E KULLOTAVE

Ing. VLASH LEGISI - Shef i seksionit të Administrim-Menaxhimit në DSHP Mirditë

- Mirdita renditet rrethi i dytë, pas Pukës, për nga madhesia e fondit pyjor.

- DSHP Mirditë administron rreth 6 % të fondit pyjor të vendit ose rreth 64 mijë ha, me rreth 6.5 milionë m³ lëndë druri.

- Mirdita bën pjesë në qarkun e Lezhës, ka dy bashki, pesë komuna dhe 59 fshatra.

Pyjet komunale janë pare si "thembra e Akilit" për zhvillimin e ekonomive pyjore në vend dhe duket se do të jenë e vetmja zgjidhje për ta shpëtuar kete resurs kombëtar nga ajo gjendje ku është futur prej vitesh. Nisur nga kjo, që në vitet 1998-2002, grupe të caktuara pune hartuan e perpunuan objektiva strategjike të ekonomise pyjore dhe kullosore. Një prej tyre është kalimi deri 40 % të sipërfaqes pyjore në përdorim të komunave. Në ligjin e ri të pyjeve (nr. 9385, dt. 4.5.2005) tashme nuk është vendosur ndonjë kufi, por komunitet lokale mund të marrin në përdorim të gjitha ato sipërfaqe që tradicionalisht janë përdorur prej tyre për kullo-

tje, lëndë druri, etj. Natyrisht, arritja e kësaj kërkoi bashkëpunim të shume aktoreve të interesuar. Ne kete veshtirim, qe nga njesite vendore, shoqatat e pyjeve, pleqesite e fshatrave dhe personeli i DSHP-se, tashme kene shume pune per te bere dhe probleme per te zgjidhur. Njohja me traditat e perdorimit te çdo komune e fshati eshte ndër drejtimet kryesore te punes në ketë fazë.

Pikerisht per kete eshte kryer nje studim i bazuar ne disa kriteret e mirefillta, per te gjetur zbatim ne vijim te procedurave te metejshme në ndarjen midis njesive vendore, fshatrave, te korijeve e zabeleve të dikurshme. Fillimisht ka patur hezitime nga disa drejtues vendore. Per vitet 1998-2005 ky objektivi u arrit në komunat Kthellë, Kaçinar dhe pjesërisht në bashkinë e Rreshenit. Nderkohe, jane kryer studime paraprake në komunat Orosh e Fan, por nuk eshte arritur te finalizohet kryerja e planit te menaxhimit dhe kalimit në përdorim të sipërfaqes pyjore.

Viti 2006 shenoi nje hap konkret per nje bashkëpunim te frytshem te DSHP-se me drejtuesit vendorë, duke mundësuar planifikim 100 % te gjithe komunave e bashkive per hartimin e planeve te reja te menaxhimit te pyjeve komunalë dhe

rishikimin e planeve per komunat qe permendem. Aktualisht, konsulentet fitues per hartimin e planeve te menaxhimit ne komuna, në bashkëpunim me kryetarët e shoqatave te pyjeve komunale dhe kryesite e fshatrave, me asistencen e specialisteve te DSHP-se, po kryejne punimet ne terren per konkretizimin e ndarjes se pyjeve ne fshatra dhe per te vazhduar me pershkrimin parcelar, qe evidenton gjendjen e pyjeve dhe percaktimin e masave silvikulturore per permiresimin e gjendjes. Me punen e bere dhe masat qe po marrim, synojme qe brenda vitit 2007 te kalojne ne përdorim te komunave e bashkive rreth 25 mije ha pyje e kullota, pra duke arritur kesisoj plotesimin e kerkesave te komunitetve vendore. Keshtu pushteti vendor tashme eshte dhe administruer i pasurive natyrore, perfshi edhe pyjet e kullotat.

Ripërtëritje e traditës, ndërgjegjësim i komunitetit

Gjithe vepritarite e ndermarra per kalimin ne përdorim te pyjeve komunalë ka si qellim ripërtëritjen e tradites se zoneve rurale qe e kane patur dikur per ruaj-

tjen e pyjeve, ndarjen e zabeleve dhe korijeve te fshatit, te drejtat dhe detyrat qe ka çdo pjesetar apo familje ne fshat per sigurimin e druve te zjarrit, lendeve te ndertimit, gjethit per bagetite, etj., veprime keto qe njihen mire nga banoret e moshuar. Vete fshati krijon nje komision me njerez te besuar, te ndihmuar nga individe te moshuar, qe pastaj shohin ne terren kufijte e zabeleve qe ka patur çdo fshat, fis apo familje, korijet e fshtarave, kufijte midis fshatrave dhe te gjitha keto behen pa diktim nga pushteti vendor apo personeli pyjor i DSHP-se.

Në vazhdim, komisioni i fshatit apo kryesia, propozojne per punimet qe duhen kryer ne keto pyje, zabele e korije, si pyllezime, sistemime malore, thurje me gardh, ruajtje nga kullotja, ngastrat e prodhimit te druve te zjarrit, lendes se ndertimit, etj., aktivitetet qe mendojne se i sherbejne gjendjes aktuale, duke sjellë nje zhvillim te qendrueshem te pyjeve komunalë per plotesimin e nevojave qe ka fshati. Pikerisht per keto synohet te arrihet ndrgjegjesimi i komunitetit, i cili duhet ta ndieje veten ne rolin e perdoruesit konkret per keto sipërfaqe pyjore te caktuara nga komisioni i fshatit. Ai tani eshte jo vetem perdorues, por edhe pergjegjes per mbrojtjen nga demtimet te pyllit e kulloses qe po merr ne përdorim.



Nga Konferenca Ndërkombëtare e mbajtur në Sofie të Bullgarisë

Zhvillimi i strategjive rajonale për bashkëpunim ndërkombëtar në menaxhimin e zjarreve në pyje

GENCIHOXHAI

Specialist në Sektorin e Koordinimit të Kontrollit për Policinë Pyjore, Tiranë

Me 19 – 21 mars 2007, në Sofie të Bullgarisë u organizua konferenca ndërkombëtare për “Zhvillimin e Strategjive për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Zjarreve në Pyje në Rajonin e Europës Juglindore / Kaukazit”. Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga Sllovenia, Kroacia, Bosnje-Hercegovina, Serbia, Shqipëria, Greqia, Turqia, Maqedonia, Bullgaria dhe Rumania.

Dokumenti i strategjisë është një draft në të cilin përkrahën aspektet që duhen marrë në konsideratë për zhvillimin e strategjive rajonale dhe bashkëpunimin për menaxhimin e zjarreve në pyje në vendet e rajonit të Europës Juglindore dhe të Kaukazit. Ky draft do të jetë objekti i diskutimeve në takimet rajonale dhe në workshope të mevojshme, në bashkëpunim edhe me Komisionin Europian të Pyjeve të FAO-s. Dokumenti i strategjisë u hartua bazuar në rekomandimet dhe eksperiencën e Qendres Globale të Monitorimit të Zjarreve në punën e saj për hatimin e

“Strategjive të bashkëpunimeve rajonale për parandalimin, kontrollin dhe luftimin e zjarreve në pyje”. Po ashtu, kjo strategji është në vazhden dhe reflekton përpjekjet ndërkombëtare për zhvillimin e Kodit të menaxhimit të Zjarreve dhe të Strategjisë për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për implementimin e kodit të menaxhimit të zjarreve.

Objektivi dhe qëllimi i strategjisë janë:

- Te nxisë e forcoje bashkëpunimin ndërkombëtar dy e shumëpalësh për krijimin e sinergjive dhe shkëmbimin e njohurive, teknikave, burimeve njëzore midis vendeve të rajonit të Europës Juglindore dhe të Kaukazit.
- Hartimi i një drafti për zhvillimin e strategjisë për bashkëpunimin ndërkombëtar për menaxhimin e zjarreve në pyje në Rajonin e Europës Juglindore / Rrjetit të zjarreve në Pyje të Kaukazit.

Ditën e parë të konferencës u prezantuan raportet e çdo vendi pjesëmarrës në

kete rrjet, në të cilët u identifikuan specifikat e shfaqjes së fenomenit të zjarreve në pyje në secilin vend, si dhe menaxhimi i fenomenit, duke identifikuar agjencitë përgjegjëse dhe kapacitetet njëzore e materiale që kanë në dispozicion.

U dhanë statistika për situatën e zjarreve në vendet e rajonit.

Gjatë konferencës u hartua një draft i strategjisë së menaxhimit të zjarreve në vendet e Europës Juglindore e Kaukazit. Në draft parashikohet të ndermerren një sere veprimesh në nivel kombëtar dhe rajonal, nga të cilët përmendim:

- Unifikimi dhe studimi i hollesishëm i statistikave mbi zjarret në pyje.
- Vlerësimi real i rrezikut nga zjarret.
- Inventarizimi i marreveshjeve dy-palëshe, grupshtetesh ose rajoni, që aktualisht janë në fuqi.
- Studimi i eksperiencës së mëparshme në marreveshjet dy dhe shumëpalëshe.
- Inventarizimi i burimeve të mundshme për ndihmën dypalëshe.
- Krijimi i logjistikes për ndihmë shumëpalëshe.
- Promovimi i shkëmbimeve teknike dhe përvjes midis vendeve të ndryshme.
- Ngritja e një qendre trajnimit për vendet e rajonit.

Në strategji është përcaktuar në terma konkrete hapat që duhen ndermarrë për arritjen e objektivit dhe qëllimit të saj. Po ashtu, në të përcaktohen përmasat politike që duhet të përfshihen si në nivel lokal edhe në atë rajonal nga secili vend pjesëmarrës.

Shqipëria është anetare e këtij rrjeti ndërkombëtar në Rajonin e Europës Juglindore, që nga krijimi i tij në vitin 2005.



Konferenca u zhvillua në praninë e eksperteve të Qendres Globale të Monitorimit të Zjarreve (GFMC), agjenci e Kombeve të Bashkuara me qendër në Gjermani dhe mbështetet nga organizata e ISDR (Strategji Nderkombëtare për Reduktimin e Katastrofave) dhe u financua nga zyra qendrore e OSBE-se në Vienë. Arsyet kryesore që çuan në organizimin e kësaj konference janë menaxhimi sa më i mirë i zjarreve në pyje, në kuadër të menaxhimit të fenomenit në nivel global – rajonal – kombëtar, duke orientuar nga hartimi i politikave në këtë sektor në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, përdorimi efektiv i burimeve njëzore e materiale.

Deri tani, si pjesë e këtij rrjeti, janë shkëmbyer informacione dhe janë dërguar të dhëna në GFMC, për zjarret në pyje e kullota në Shqipëri, si dhe raporte perkatëse, të cilat janë të publikuara në faqen e internetit të GFMC. Po ashtu, nga pjesëtarët e këtij rrjeti është marrë ekspertizë shumë e vlefshme në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Zjarreve në Pyje e Kullota, tashme e miratuar me VKM.



Nga një veshtrim i përgjithshëm vihet re se ka mjaft shembuj pozitivë për ripërtëritjen e traditës popullore për ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të fshatit. Janë masive të gjera dushkajash në afersi të fshatrave, që janë permiresuar, janë ndaluar prerjet e paligjshme, kujdesi është shtuar nga banoret vendas. Sipas mundësive dhe vlerësimit real të pyjeve, vihet re se janë kryer punime dhe është kushtuar kujdes ndaj sipërfaqeve të tera pyjore në afersi të shtëpive, duke mundësuar zhvillimin dhe rritjen e druveve pyjore. Të tjere kanë bërë rrethime me gardh në sipërfaqe të vogla pyjore, për t'i ruajtur nga demtimet. Në shumë lagje e fshatra është bërë konkretizimi i njohjes së kufijve të zabeleve e korrive. Ka prirje edhe për mbjellje të reja, si akacie, plep kavak, shpatulla shelgu e rrap, etj., që ndikojnë dukshëm në sistemin e tokave dhe mbrojtjen e tyre nga erozioni.

Në kuadër të zbatimit të Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN) gjatë këtij viti është bërë një punë shumë e mirë në njesitë vendore Rubik, Rreshen, Kaçinar e Orosh, ku ka patur sensibilizimin në rritje për pyjet komunalë. Në takimet e bera në komuna, për prezantimin e hapave që do ndiqen në hartim apo rishikim të planeve të menaxhimit, përveç stafit teknik të konsulencës, kanë referuar dhe

kane sjelle përvjes specialistet e njohur Thimaq Lako, Arsen Proko, Haki Kola, Jani Male, etj. Nderkohe, konsulenti për përgatitjen e planeve të menaxhimit në disa komuna të Mirdites, kompania “Diava Consulting”, me drejtues teknik ing. Abdulla Diku, ka përgatitur e shpërndarë për çdo familje një numër të madh fletëpalosjesh, ku vihet në dukje dobia e pyjeve komunale, hapat në realizimin e planeve të menaxhimit, me pjesëmarrje të komuniteteve lokale, etj. Pra, përveç takimeve të zgjeruara në komuna, me pjesëmarrës nga çdo fshat, informimi dhe ndergjegjësimi për pyjet e kullotat komunale, me mbështetje nga PZHBN, është synuar të shkojë në nivel familjesh e përdoruesish. Pa dyshim, një fushatë e tillë ka dhënë rezultate; tashme procesi ka pjesëmarrje me të gjere, ai po behet i njohur për të gjithë të interesuarit për pyjet e kullotat komunale. Pra, konsulenti “Diava Consulting” po e vë theksin në një fushatë të plote informuese, sensibilizuese në nivel fshati dhe përdoruesish, gjë që ka munguar më parë.

Punime në pyjet komunalë

Gjatë periudhës 2001-2003 në njesitë vendore Rreshen, Kaçinar, Kthelle e Selitë u kryen mbi 200 ha permiresime pyjore, kryesisht në ngastra pyjore me llojin lis, për të mundësuar zhvillimin normal të pyllit

te ardhshëm. Po ashtu, janë kryer mbi 400 m³ sistemime malore me mure të thate e brez betoni (Kaçinar-Selite). Të gjitha keto investime janë mbështetur nga Projekti Shqiptar i Pyjeve, financuar nga BB. Përfutjesit e të ardhurave nga puna e tyre janë shprehur mjaft të kenaqur nga pagesa dhe shërbimi që po i kryhet ekonomisë pyjore, si dhe mbrojtjes së tokës nga erozioni. Janë vete banoret që e ruajnë atë që kanë sistemuar. Mund të përmenden për këto banoret e fshatrave Nderbungaj, Nderfane, Shengjergj, Qafa e Kishes, etj. Me mbështetje të Programit Botëror të Ushqimit për dy vite radhazi janë kryer punime të thjeshta në afersi të lagjeve, toke-ara, rrugeve auto, etj., në përfitim të një pakete ushqimore. Pavaresisht nga kjo duhet theks se janë kryer punime të konsiderueshme në Kthelle, Kaçinar e Fan dhe pjesërisht në bashkinë e Rreshenit. Kryerja e punimeve, pra angazhimi i banoreve në punë me shpërblim, ka rol pozitiv, jo vetëm për sigurimin e të ardhurave financiare, por ndikon edhe në paksimin e prerjeve ilegale. Edhe në zbatimin e PZHBN, për çdo komunë që do hartohet plani i menaxhimit për tre vitet e para do mbështet me investime kryerja e punimeve të projektura. E rëndësishme tashme është që jo vetëm personeli pyjor, por shoqatat e pyjeve, në komuna dhe vete pushteti vendor, të jete në rolin kryesor për kryerjen çilesore të punimeve.

E ardhmja pyjeve si pronë e komunës

Kryerja studimeve, hartimi e rishikimi i projekteve të menaxhimit të pyjeve komunale, krijimi i shoqatave të përdorimit të pyjeve, njohja e kufijve midis fshatrave e njesive vendore, ndergjegjësimi dhe pjesëmarrja direkte e komunitetit për permiresimin e gjendjes së pyjeve të fshatit, si dhe aktivitete të tjera, krijojnë kushte për rritjen e përgjegjësisë të banoreve dhe drejtuesve të pushtetit lokal për miradministrimin e kësaj pasurie të pazvendësueshme. Pra, nëse në fazën e parë konsiderohet kalimi i pyjeve në përdorim të komunës, në një fazë të ardhshme do të kalohet në “pyjet në pronësi të komunës”. Ky kapërcim, natyrisht nuk arrihet lehtë e me një të rënë të lapsit, duhet shumë punë e të gjithë aktorëve të interesit për të dhënë sinjalin e besimit komunitar që të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm i pyjeve komunalë, pra për të arritur plotësimin e nevojave që kanë ata për lende drusore dhe produkte jopyjore.

Thënë me qartë, në këtë fazë kërkohet nga komunat, fshatrat, shoqatat e çdo përdorues pylli e kullote, që jo vetëm punimet e investimet të behen, por, mbi të gjitha, të ruhen pyjet nga prerjet ilegale, zjarret, apo çdo veprim tjetër, që e demton pyjet, si një resurs i se tashmës dhe të ardhmës.

(Botuar për herë të parë në gazetën “Mirdita”, dhjetor 2006)

Aspekte gjeoturistike të Alpeve shqiptare

Mbërrin guida malore

nga Prof.As. Dr. KUJTIM ONUZI
Shoqata Kombëtare e Studimeve Malore



Në Alpe bëjnë pjesë ekosisteme me bukuri të rralla natyrore. Peisazhi malor alpin i mrekullueshëm, me florën e larmishme, kataraktet karakteristike, burimet ujore në formën e lumenjve, përrënjeve apo burimeve natyrore sipërfaqësore, përbëjnë bazën dhe ekzistencën e këtyre ekosistemeve. Malet me kontraste të larmishme të relievit të tyre japin mundësi të mira për zhvillimin e sporteve dimërore e verore, si turizmi malor, alpinizmi, kacavjerrjet, skitë, hipizmi, përdorimi i kajakeve në kanione, peshkimi amator në kanione e lumenjtë e rrëmbyeshëm, çiklizmi malor etj.

Larmia e madhe e peisazhit natyror, folklorit, kanunit, historisë etj, përbëjnë një bazë të mrekullueshme për zhvillimin e gjeoturizmit malor dhe paraqet mundësi të mira për të sjellë turistë aktivë në Alpet Shqiptare.

Si rezultat i gjithë aspekteve dhe studimit të kryer me mbështetjen financiare të UNESCO-s, Alpet Shqiptare ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit malor në këto fusha: i) gjeoturizëm, gjeomonumente, gjeoparqe, dukuritë karstike, etj.; ii) sportet dimërore, alpinizëm, ski, kacavjerrje në akull, etj.; iii) sportet verore, ecjet malore, kacavjerrjet shkëmbore, çiklizëm malor, kajaka, kanotazh, hipizëm, gjueti, etj.; iv) vizita në ekosistemet, pyje, liqene, lumenj, etj.

Zhvillimi i zonës së Alpeve Shqiptare, ndërgjegjësimi çdo ditë e më tepër i strukturave shtetërore dhe atyre vendimmarrëse si edhe i komunitetit lokal jep përherë e më shumë premisa për ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre ekosistemeve malore nga më të bukurit e vendit tonë. Kjo ka të bëjë me zhvillimin e një jetese të qëndrueshme në këto zona, të cilat po braktisen me shpejtësi nga popullsia, e cila nuk ka mundësi reale për një jetesë normale sepse dhe të mirat që ofrohen nga kjo zonë janë të pamënaxhuara, të paekspozuara ndaj turizmit vendas dhe të huaj. Nxitja dhe zhvillimi i këtyre burimeve natyrore, duke ruajtur në mënyrë thelbësore mjedisin dhe duke marrë si bazë zhvillimi rajone analoge të Evropës, do të përbëjë një bazë të fuqishme për ndalimin e braktisjes së vendbanimeve nga banorët e këtyre zonave. Për këtë ne ofrojmë dhe një potencial të ri për zhvillimin e rajoneve ku lokalizohen Alpet.

Guida malore e Alpeve Shqiptare paraqitet për rajonet që përfshihen ndërmjet Shkodrës - Bajram Currit - Vermoshtit - Koplikut dhe është realizuar duke bërë vrojtime në terren, si dhe shfrytëzuar materiale të tjera.

Shoqata Kombëtare e Studimeve Malore, në bashkëpunim me Shoqatën e Alpeve, si dhe me institucione e organizma të ndryshme shqiptare e të huaja dhe me mbështetjen e UNESCO, realizuan Guidën Gjeoturistike të Alpeve Shqiptare, duke e paraqitur atë në tre elemente përbërës:

1. Guida Gjeoturistike e Alpeve Shqiptare (Top Tour CD)
2. Harta 1:100 000 Top Tour Alpet Shqiptare (Hartë 90 x 80 cm)
3. Alpet Shqiptare, Aspekte Gjeoturistike. (Tekst)

(Marre nga revista "Mjedisit Sot")



Lulet e mia kënaqësia juaj

nga Ing. GJON FIERZA

Gjelbërimi dhe zbukurimi i mjediseve, është një kërkesë gjithnjë në rritje, në sasi e cilësi. Janë dhjetra pallate, qindra shtëpi banimi në qytete e fshatra, që ndërtohen çdo vit; të gjitha e kanë të nevojshëm e të domosdoshëm sistemimin e mjedisit ku ndodhen, pasi vetëm kështu u rriten vlerat e përdorimit.

Natyrshëm, kur sheh një shtëpi (vilë) apo një pallat banimi, krahas arkitekturës së ndërtesës tërheq vëmendjen mjedisi përreth, sistemimi e gjelbërimi i tij.

Gjelbërimi dhe lulet kanë vlera të mëdha estetike jo vetëm në mjediset publike, por edhe në ato shtëpiake, pasi krijojnë një gjendje shpirtërore e shëndetësore më të mirë. Mjedisit i bukur e me lule çlodh vështrimin, ndikon drejtpërdrejt në qarkullimin e gjakut, në qetësimin e sistemit nervor e, për rrjedhojë, në rritjen e rendimentit të punës.

Aq më tepër, mjedise të tillë janë të pazëvendësueshëm për fëmijet dhe të moshuarit.

Bimët e sidomos lulet, janë mbrojtësit më të mirë të mjedisit. Ato pengojnë pluhurin, rrezatimin e fortë diellor, zhurmat. Pengojnë erërat e rregullojnë lagështirën, mbrojnë tokën dhe krijojnë mikroklima të përshtatshme për jetesë.

Bimët zbukuruese janë bashkudhëtare në jetë me njeriun. Ai, ato i ka pranë, në shtëpi e në punë, në ditë pushimi e feste, në gëzime e fatkeqësi. Ja, pra, pse të gjithë duhet t'i njohim, të kujdesemi, t'i mbrojmë lulet e në përgjithësi bimët e gjelbra. Është ky motivi kryesor, që e ka shtyrë **Doktorin e Shkencave Selman Mëziu** të marrë përsipër përgatitjen e këtij libri dhe ta verë në shërbim të specialistëve, lulishtarëve e aq më tepër të amatorëve të panumërt dashamirës të luleve.

Ky botim është rezultat i një veprimtarie mëse dhjetëvjeçare të autorit në këtë fushë, i konsultuar edhe me literaturën dhe praktikën më të reja të kultivimit të luleve dhe arkitekturën e gjelbër në përgjithësi, gjë që i jep vlera të veçanta e bashkëkohore këtij libri.

Përvojën e punës së autorit në një vend si Italia (e njohur për mrekullitë në gjelbërim dhe arkitekturën e mjedisit), lexuesi do ta gjejë në këtë botim të paraqitur thjeshtë, saktë e kuptueshëm për të gjithë.

Dashamirësit e natyrës, kultivuesit e luleve, gjelbëruesit e mjediseve në përgjithësi, tashmë kanë një mundësi më shumë për sukses në punën e tyre. Libri "Lulet e mia, kënaqësia juaj" ua mundëson atë.



Shpendët dhe Gjitarët e Shqipërisë

Prof. Dr. IDRIZ HAXHIU

Sistemet silvopastorale antishkretëtirëzues

nga Dr. ENDRIT KULLAJ



Botimi "Sistemet silvopastorale antishkretëtirëzues në Rajonin Mesdhetar Jugperëndimor", me autorë **Inxh. Ferdin Liçaj** dhe **Inxh. Haki Kola**, vjen në një periudhë kritike të zhvillimit të vendit, kur aktorët politikëbërës janë në kërkim të modeleve më të mira për të integruar objektivat e zhvillimit ekonomik me qëndrueshmërinë mjedisore. Punimi është shkruar me gjuhë të thjeshtë për të patur audiencë sa më të madhe, veçanërisht për banorët e këtyre komuniteteve, të cilët janë aktorët e parë që duhet të ndërgjegjësohen nëpërmjet tij.

Konteksti pedoklimatik mesdhetar i Shqipërisë në perspektivën e ngrohjes globale dhe rritjes së popullsisë, e cila shoqërohet me një trysni më të madhe mbi mjedisin, ka ngritur prej kohësh shqetësimin mbi dukurinë e shkretëtirëzimit, e cila "po gllabëron" çdo vit qindra hektarë të çmueshëm tok. Frenimi i një procesi të tillë, mbi të gjitha, kërkon ndërgjegjësim të komuniteteve rurale që administrojnë ekosistemet.

Autorët, mbështetur në përvojën egjatë të punës me sistemet pyjore e kullimore dhe veçanërisht me komunitetet që jetojnë brenda tyre, propozojnë qasje konkrete mbi ngritjen e sistemeve silvopastorale antishkretëtirëzues. Sistemet e propozuara integrojnë mjaft mirë nevojat e komuniteteve njerëzore (individëve, popullatave dhe komuniteteve që bashkëveprojnë ose kundërveprojnë mbi bazën e interesave dhe vlerave) dhe të ekosistemeve, duke krijuar agroekosisteme që lidhin faktorët abiotikë të një mjedisi dhe komunitetet e popullatave dhe organizmave që jetojnë në një zonë të caktuar. Objektivi përfundimtar është qëndrueshmëria, një cilësi e ndërveprimit të komuniteteve dhe vendit, që konsiston në ekosisteme të shëndetshme, ekonomike, vitale dhe barazi sociale.

Ky punim, i paraqitur në mënyrë modeste, shërben si një udhëzues i mirë për politikëbërësit, por edhe fermerët, prandaj dhe e rekomandojmë pa ngurrim për cilindo që në orvatjet e tij, individuale apo kolektive, ndjehet i përgjegjshëm ndaj mjedisit dhe krijimit të vendbanimeve të qëndrueshme.

Libri "Shpendët dhe Gjitarët e Shqipërisë", i autorëve **Taulant Bino**, **Haki Zoto** e **Ferdinand Bego**, përbën një kontribut me vlerë dhe arritje të veçantë në fushën e studimeve dhe botimeve për faunën e vendit tonë. Është një punim që nderthur në menyre të perkryer njohurite praktike me ato shkencore.

Libri percakton fillimisht qarte menytrat dhe metodat se si duhen vrotuar shpendet dhe gjitarët, gjë që duhet dhe udhëhiqet nga disa parime bazë. Kjo pjesë e pershkruar në tekst si "Rregullat e Arta të Vrojtimit", është e rëndësishme për njohurite që jep, por sidomos për mesazhin që ofron: "Të studiojme botën e gjallë për ta ruajtur, mbrojtur e ndihmuar atë më shumë".

KOPLIKU, QENDRA E NJË TREVE TË PASUR NË HISTORI E TRADITË



nga Prof.As. Dr. AHMET OSJA

Në veriperëndim të qytetit të Shkodrës, rreth 20 km larg, ballë Alpeve e afër liqenit, në fushën që në shekuj ka marrë emrin fusha e Mbishkodrës, që në lashtësi janë hedhur themelet e një qendre banimi me rendësi ekonomike e shoqërore, që thirret Koplik.

Aty ku kryqëzoheshin rrugët që të çonin në Dalmaci dhe Dardani, që sot quhet Pikëza, dikur ishte një qendër me rendësi në aksin e rrugës që nisej nga Naroni, një rrugë, e cila duke kaluar nëpër Dukle (Mali i Zi), arrinte nga fusha e Koplikut në Shkodër. Si stacion ikësaj rrugë në tokën shqiptare (brenda kufijve të sotëm politikë), shënohet Çinna. Sipas tabelës Peuntingeriane (ky stacion ishte 20 milje) në Veri të Shkodrës (sipas J. Adam) nuk mund të caktohet me siguri se ku ka qenë ky stacion, por po të marrim parasysh largësinë, ai duhet të ketë qenë në afërsi të Koplikut (sipas H. Kipert), duke patur parasysh rëndësinë që ka patur Shkodra që në fillim të historisë së saj, si qendër komunikimesh e pozitë strategjike, duket se ajo rrugë duhet të ketë qenë në veprim që në kohë të hershme dhe se ka luajtur rol në luftrat e ilirëve me romakët.

Në Koplik gjejmë gjurmë të hershme, që i takojnë epokës së bakrit dhe përfaqësohen nga disa sèpata dhe dalta bakri. Njëra nga këto sèpata i përket fillimit të mijëvjeçarit të dytë para erës sonë dhe dy dalta, që përfaqësojnë tipin më të hershëm të veglave metalike prej bakri, që i përkasin mijëvjeçarit të tretë para erës sonë ... Nga epoka e bronzit është gjetur një sèpatë tip shkodrane dhe një tjetër e tipit shqiptaro - dalmate.

Epoka e hekurit në këtë zonë është e përfaqësuar nga një vëndbanim i fortifikuar mbi kodrën e Marshejit, si dhe një numër tumbulash, që tashmë janë rrafshuar, që të bindin arsyeshem se fshati Koplik është vendngulim shumë i hershëm e pse jo po kaq i hershëm edhe emri i tij. Studiuesi Giuseppe Valentini e dokumenton që në vitin 1398 emrin e fshatit Copionich (Kopionik) dhe se banorët e këtij fshati janë vendas. Ndërsa vazhdimësia e popullimit del nga të dhënat e viteve 1416 (89 shtëpi), 1485 (70), 1582 (267) dhe 1614 (60 shtëpi). Nga 116 fshatra që gjenden në regjistrin e vitit 1416, 42 janë mbi Shkodër dhe Kopliku ka 30 % të familjeve të fshatrave të Mbishkodrës. Pra vërtetohet se kjo qendër është banuar mirë dhe të dhënat e numrit të familjeve përrreth 200 vjet tregojnë se Kopliku ka ruajtur mirë rëndësinë e një qendre urbane, duke i shpëtuar emigracionit në trevën e Shkodrës

Për çdo person të interesuar pas natyrës dhe faunës ka gjithmonë nevojë për disa të dhëna fillestare: Ku duhen kërkuar gjurmët e ariut apo sorkadhes? Ku janë mundësitë më të mëdha për të parë lejlekun apo shqiponjën? Sigurisht që pa një udhëzues, secili prej nesh mund të humbiste kohë për të kërkuar një lloj aty ku ai nuk ka mundësi të gjendet. Pikërisht përdorimi i këtij libri do të kursente kohën e shumë vëzhguesve. Ai jep të dhëna themelore rreth jetës së pjesës më të madhe të shpendëve e gjitarëve, që një vëzhgues i vëmendshëm mund të shohë në harkun kohor të dy apo tre vjetëve.

për vitet 1478 - 1479. Në dokumentet e vitit 1351 Kopliku përshkruhet si fshat i zhvilluar mirë në bujqësi, blegtori dhe në rritjen e bletës. Veprimtaria ekonomike mbështetej kryesisht në kultivimin e vreshtave. Në vitin 1416, banorët dorëzonin të dhjetën e verës prej mbi 400 litra në vit, çfarë do të thotë se kjo kulturë (hardhia) njihej mirë në këtë zonë. Fakti që edhe sot një kultivar quhet "Koplike", tregon për këtë. Pas viteve 1800, vendin e hardhisë e zuri bima e duhanit; edhe në këtë bimë u tipizuan lloje "Kopliku", ndërsa pas vitit 1970 u kultivuan edhe bimët eterovajore.

Fakti pse Kopliku s'ka qenë qendër qysh heret, varet edhe nga organizimi i "Maleve" (Hot, Grudë, Kelmend, Kastrat e Shkrel), që kishin një organizim brenda për brenda, gjë që nuk lejonte varësi administrative. Po ashtu, afërsia me qytetin e Shkodrës, nuk favorizonte krijimin e një qytetëze, si dhe pozicioni gjeografik në fushën ku mungonte mundësia e një fortifikimi, bënë që deri në fillim të shekullit tonë Kopliku të mos ishte qytezë dhe qendër rrethi. Por, si një vend ku kryqëzoheshin rrugët, vend me hapsirë ekonomike, si dhe me familje vendase me emër të mirë, që ruajtën gjithnjë traditat e Malësisë së Madhe, së cilës i takonin, bënë të mundur që në këtë qender, në vend të kryqëzimit të rrugëve të hershme, të ndërtohej ujësjellësi (edhe sot gjenden pjesë të tij), mulliri i gurrës dhe valanicat e gurrës dhe në Gadej ishte stacioni ku shërbeheshin kuajt për linjën drejt Dalmacisë dhe Dardanisë. Është fakt se që në vitin 1614 në Koplik gjendet një kryefamilje me emrin Pecha Campersa, që duket se jetonte në memorjen e popullatës me emrin Perç Kambësa. Ky emër na kujton emrin e familjes Kamsi, familje e rrjedhur nga Engjellorët e Derivastit të hershëm, bir i sëcilës ishte Pal Engjëlli, që në trevën e Matit, me 8 nëntor 1462 shkroi "Formulën e Pagëzimit". Sipas studiuesve, emri Kamsi ka lidhje me profesionin e financierit. Duhet të ketë lidhje mbiemri i familjes Xhabia, ardhur nga Kopliku në Shkodër, i cili po ashtu, do të thotë financier. Të parët e Xhabiajve janë ulur prej Koplikut dhe në fillim quheshin me llagapin Kopliku (sipas H. Bushati). Titulli "Xhabi" iu dha kësaj familjeje që me Hasan Agën. Ka të dhëna që me 1865, kur qeveria zbriti nga kështjella, personeli administrativ u vendos në sarajin e Xhabiajve. Kjo familje, në të dalë të pazarit të Shkodrës ndërtoi sarajet, xhaminë, mejtepin dhe varrezat e koplikajve (xhabiajve) dhe lagjja quhet Xhabiaj. Nga kjo familje dhe të tjera të ardhura nga Kopliku, i dhanë qytetit të Shkodrës për mëse 300 vjet shumë personalitete. Një nga këto familje është edhe ajo e Llazanve, e cila dokumentohet që në vitin 1728. Selim Sulejman Llazani kishte rol të ndjeshëm në tregtinë që bënte qyteti i

Shkodrës me Venecien dhe Triesten. Në fillim të këtij shekulli në Shkodër u vendos edhe familja e Abdyl Bajraktarit. Në Lahutën e Malësisë u këndohet shumë bijve e bijave të Malësisë së Madhe, si pjesëmarrë në luftimet që bëri Oso Kuka në Vraninë në vitin 1864. Shumë burra nga Kopliku dhe Rranxat janë protagonistë të luftës së Vrakës, ku mbetën shumë dëshmorë, por fituan të drejtën që të trajtohen si të barabartë me "5 Malet", për të mos dërguar ushtarë, paguar taksa dhe të mbajnë pushkët. Luftrat që malësorët bënë nga viti 1909 - 1912 kundër turqëve patën protagonistë shumë luftëtarë nga Kopliku. Kopliku luftoi gjithashtu edhe kundër hordhive malazeze gjatë viteve 1913, 1915 dhe në vitin 1920, në luftë me ushtritë jugosllave u dalluan shumë luftëtarë nga Kopliku. Kjo luftë në histori mori emrin Lufta e Koplikut.

Në vitet '80 të shekullit XIX administrata turke në Shkodër e njihte Koplikun si qendër të xhibalit. Në vitet 1916 - 1918, në Koplik u instalua administrata, duke përfshirë edhe vendkomandë, postë-telegrafë, zyrë e punëtorisë së ndërtimit të rrugës, që lidhte Shkodrën me Podgoricën. Pas vitit 1920, Kopliku u bë Nën-prefekturë e Shkodrës dhe qendra filloi të marrë pamjen e një qyteti, si akumulues e rrezatues i vlerave kulturore të trevës së Malësisë së Madhe.

Mendimi se Kopliku dhe malësitë e tij përreth kanë qenë që heret trualli ku është ngjizur kultura primitive na bën të mos e trujtojmë si rastësi shfaqjen e Eposit të Kreshnikëve pikerisht në këtë zonë dhe aq më tepër plotësia e kësaj veprë bën të thellohem në idenë se duhet të ketë vlera të tjera, ndoshta po kaq të arrira sa Eposi, që nuk janë eksploruar akoma (një model për këtë është Lahuta e Malësisë nga Pader Gjergj Fishta). Ato ruajnë gjendjen e tyre të konservuar, të gatshme për të na u servirur si dëshmi historiko - gjuhësore të popullit tonë. Eposi përbën një vlerë me shtrirje kombëtare. Ruajtja e tij është arritur në saje të dëshirës së madhe të Malësorëve të Veriut për ta paraqitur si shenjë e autoktonisë dhe origjinalitetit, duke e transmetuar brez pas brezi, herë pranë vatrës së kullës, herë nën hijen e mrizave, krjove e lëndinave të bjeshkëve, velëm gojarisht, pa nundur ta shkruajnë. Kujtesa e tyre ka shërbyer si muze i gjallë shekuj me radhë dhe s'mbetet këtu. Edhe kultura muzikore e bollshme flet për një plotësi të shpirtit prej artisti të njerëzve që kanë jetuar e jetojnë në këto

trevë. Vegla të veçanta, që identifikojnë kulturën e këtij vendi, si zumraja, çiftelia, lahuta, fyelli e të tjera, flasin për një traditë të mirë në këtë fushë. Ndoshta rol jo të vogël ka luajtur edhe natyra. Zëri i pastër e melodioz ka shoqëruar basifonët - malësorë në këngët e tyre maje - krahut (të pakrahasueshme për nga lloji me të tjerat). Te këta këngëtarë mund të shihen tenorët e parë të muzikës shqiptare.

Zbukurimi është më i vjetër se veshja. Synimi për të bukurën është më i fortë se nevoja e funksioni vetë dhe ky fakt vihet re si në ornamentet e veshjeve të malësoreve që nga hershmëria e deri tek xhubleta (forma më e përsosur e veshjes). Kjo veshje karakteristike, që takohet në zonën e Koplikut dhe në gjithë Malësinë e Madhe, ka të dhëna historike që studiuesi i vjetër gjerman Oberlant shprehet se i takon kulturës Minoike, 3500 vjet më parë. Larmia e veshjeve e të dy gjinive s'janë përgjigje



vetëm e nevojave të ditës ose e kushteve të mjedisit, përkundrazi, këto veshje e kalojnë cakun e dobishmërisë së përditshme dhe bëhen pikturë, art e spektakël. Për të gjitha këto dhe të tjera, që ka kultura e Koplikut, mendojmë se do të ishte e drejtë hedhja e idesë për organizimin e një Festivali Folklorik Kombëtar në këtë zonë, që është vendlindja e Eposit dhe e shumë veglave muzikore dhe veshjeve.

Gjithë kjo pasuri kulturore e bën të domosdoshme ndërtimin e një qendre kulturore bashkëkohore, që të plotësojë nevojat e këtij qyteti. Kopliku si qendra e Malësisë së Madhe ta mbajë të gjallë e ta rrezatojë këtë pasuri kulturore me interes mbarëkombëtar. Po ashtu, në Koplik duhet ngritur Muzeu, Biblioteka, Stacioni i Radios e Televizionit e të tjera. Kjo edhe për faktin se Malësia e Madhe shtrihet edhe jashtë kufijve të sotëm shtetërorë. Hartimi i projekteve ambicioze e të argumentuara, si dhe rendja për të gjetur sponsorë, si në rrugë shtetërore edhe nëpërmjet organizatave joqeveritare, do të bënte të mundur që në një kohë të shkurtër edhe qyteti i Koplikut, si qendër e rrethit të Malësisë së Madhe, të ketë mundësi për të ruajtur këtë kulturë aq të çmuar.

Ai është hartuar në formën e një libri xhepi, për vëzhgues që kanë dëshirë të udhëtojnë në Shqipëri dhe të mësojnë për pasurinë llojore të saj.

Botimi jep fillimisht një përshkrim anatomik, si dhe variacionet e tij në përputhje me sezonet. Më pas ai ndalet në mënyrën e jetesës së llojit, duke u përqëndruar me mjedisin ku jeton, ushqimin që ha, tiparet më karakteristike të folezimit apo dimërimit.

Percaktimit, njohjes dhe dallimit të llojeve u vijne në ndihme një sere tiparesh, karakteristikash e veçantish si, permasat,

ngjyrat, zonat e perhapjes, aromat, mbetjet ushqimore, gjurmet, jashtëqitjet etj. Sidomos për shpendet, autorët kanë ofruar edhe detaje të zerit apo kenges, duke qene se keto ripare shpesh janë themelore në percaktimin e llojit.

Ky liber perben perpjekjen e pare te ketij lloji ne vendin tone. Me shume se nje burim njohjeje dhe informimi, ai do te jape kontributin e tij per njohjen dhe ruajtjen e llojeve te rralla e te rrezikuara te shpendeve e gjitareve, me te cilet njerezit jane pak te njohur. Libri do t'u vije ne ndihme studenteve te biologjise dhe te pyjeve, nxenesve te shkollave, punonjesve te

sherbimit pyjor dhe gjuetareve. Ai do te ndihmoje punen e inspektoratit mjedisor, te pyjeve dhe peshkimit, si dhe punonjesit e doganave, te cilet i ngarkon ligji me detyren e ndalimit te gjuetise dhe tregtise se llojeve te mbrojtur nga konventat nderkombetare dhe legjislacioni shqiptar. Libri do te jete nje dritare me shume diturie per te gjitha dashamiresit e natyres qe jane interesuar per te ditur e mesuar me shume nga kjo bote sa e larmishme aq dhe interesante e jetes se eger dhe qe duan te kontribojne per nje mjedis natyror me te pasur e me te shendetshem.

Në kujtim të "pionierit" të mekanizimit të shfrytëzimit të pyjeve

- 70 VJETORI I LINDJES SË INXHINIERIT YLLI GUSHO -

Prof. Dr. MIHALLAQ KOTRO
Inxh. GJON FIERZA
Dr. GENCIKACORRI



Kontributi i tij ka qenë i pranishëm jo vetëm në ndërmarrjet ku "paguhej", por dhe në ndërmarrje të tjera, duke ndihmuar konkretisht në zgjidhjen e problemeve të shfrytëzimit të pyjeve, kryesisht me teleferikë.

Ishte pervoja e fitur në vite, që e ndihmoi Yllin të kontribuonte me sukses në ideimin e projektimit e disa tipe teleferikësh për transport lënde drusore. Pas eksperimentimit dhe shtrirjes në masë të teleferikëve të thjeshtë pyjorë të tipit ziviceran, çek e polak, si dhe të atyre të prodhuar në ved, inxh. Ylli Gusho do të drejtonte grupin dhe do të merrte përsipër projektimin dhe realizimin e teleferikut të tipit industrial, siç ishte ai i Hotolishtit, i pari dhe i vetmi teleferik i ndërtuar në vendin tonë për transport lënde druri. Një punë intënsive, me orë të zgjatura, shumë netë pa gjumë do të kalonte ai dhe kolegët deri sa vendosi në punë këtë teleferik.

Përkushtimi, devotshmëria për profesionin, niveli i lartë teorik e praktik, padyshim do të bënin që në vitin 1981 Ylli të zinte një vend të merituar në Byronë e Studimit dhe Projektimit të Industrisë së Drurit, në sektorin e Teleferikëve. Qysh një vit më parë ai kishte filluar të punonte për temën e disertacionit, duke qenë ndër të parët që mbronte disertacion me udhëheqje të Katedrës përkatëse dhe të Fakultetit të Pyjeve. Pas një pune mëse pesëvjeçare, më 1986 ai merr titullin "Kandidat i Shkencave", ndër të paktët specialistë jashtë sferës akademike që e meriton këtë titull. Ishte ky punim tregues i profesionalizimit të lartë dhe i nivelit shkencor të tij. Më pas ai punoi me një varg projektesh dhe zbatime në terren, që kishin të bënin me shtrirjen e transportit të lëndës së drurit me teleferikë në terrenet malore të vendit tonë.

Inxh. Ylli Gusho ishte ndër të parët, që hodhi idenë e ndërtimit të një teleferiku për udhëtarët, nga Kinostudioja në Dajt, vepër kjo që u realizua me sukses shumë vite më pas po nga specialistë të pyjeve, nga ish-kolegë e bashkëpunëtorë të tij.

Është e rëndësishme të njihet e vlerësohet edhe veprimtaria botuese

e Ylli Gushos. Kontributi i tij në fushën e botimeve arrin në mijëra faqe, ku përfshihen tekste mësimore universitare për teleferikët, motosarrat e mekanizmat e tjera të shfrytëzimit të pyjeve, si dhe monografi, broshura e artikuj shkencorë, apo recensione e opinionet për grada shkencore. Ka botuar gjithashtu edhe publicistikë në shtypin e kohës, në shumë gazeta e revista.

Tekste mësimore: Teleferikët (1971), Teleferikët (b/autor, 1986), Mekanizmi i Shfrytëzimit të pyjeve (b/autor, 1987), Mekanizmi pyjor (b/autor, 1987);


Libra: Manual i motosarristit (1975), Mekanizmat e shfrytëzimit të pyjeve (1980), Shfrytëzimi i pyjeve (1984);

Monografi e broshura: Motosarrat (1971), Teleferikët pyjorë (1972), Disa këshilla mbi mirëmbajtjen dhe defektet e motosarrave (1972), Shfrytëzimi racional i pyjeve dhe i lëndës së drurit (1973), Projektimi dhe montimi i teleferikut TF-500 (1986), Projektimi dhe montimi i teleferikut TVA 1000 (1987).

Aspekt tjetër tëper i rëndësishëm i jetës së Ylli Gushos është pasioni për sportin e sidomos për sportet dimërore. Është i pari në vendin tonë, që u mor me projektimin dhe ndërtimin e skipistave bashkëkohore. Ai dha ndihmë të veçantë në ngritjen e linjës së prodhimit të skive e slitave në Ndërmarrjen e Përpunim-Drurit Korçë. Ka marrë pjesë si gjyqtar i kategorisë së parë pothuaj në të gjitha kampionatet e skive, lokale e kombëtare, të zhvilluara deri në vitin 1991.

Për punën dhe kontributin në sektorin e shfrytëzimit të pyjeve, në mekanizimin e transportit të brendshëm të lëndës së drurit, në vitin 1981, Ylli Gusho u nderua me "Medaljen e Punës", ndërsa në vitin 1988 u dekorua me "Urdhrin e Punës Klasi III".

Ishin keto disa radhë, që i sollëm për lexuesit, në këtë përvjetor të lindjes, kur inxh. Ylli prej disa vjetësh i mungon familjes e të afërmeve, por a mungon e dhe ne kolegëve, i mungon pylltarisë shqiptare. Jeta nuk deshë që urimet për 70 vjetorin ai t'i merrte drejtpërdrejt. Nderim e respekt për punën dhe kontributin e tij.



Si e pret pranverën e sivjetme mali i Skënderbeut në Krujën e lashtë

HAMIDLAMA

Kryetar i Shoqatës së Pyjeve Komunalë "Lugapaj", Kurbin



Banorët e Krujës krenohen me këtë emër të madh që u la fati. Por, kohët ndryshojnë dhe krenaria e vlerat historike lypset të ruhen e të çohen më përpara. E trashëguara, sado e vjetër qoftë, duhet harmonizuar me të sotmen, duke parë gjithmonë nga e ardhmja.

E themi këtë sepse na i dikton e tashmja!

Kush kalon në këto anë, pyet me kureshtje: Sa fajtor paska qenë ky Mali i Skënderbeut? Përse këto kreshta s'pushojnë së sulmuari kurrë? Përgjigjja është e thjeshtë: Skënderbeu paska qenë mendjendritur e i pamposhtur. Ai shkoi në mal, qiti shpatën e nxorri ujë për të pirë ushtria dhe uroi "këtu të dalësh e këtu të humbasësh" dhe vërtet kështu vazhdon sot e mot; për këtë u quajt Kroi i Skënderbeut. Princi, pasi u çlodh pak, mori rrugën për poshtë, për në fshatin Vinjoll, në vendin ku bëhet rrushi, sidomos ai i Tajkës. Prandaj e mori këtë emër, se Vinjoll do të thotë vend vreshtarie. Prej andej, nata e zuri me ushtrinë e tij në arat e Tanushajve, ku sot ndahen fshati Vinjoll me fshatin Gallatë, ku i dehej të bënte një pushim të gjatë e të përgatitej për beteja të reja me taboret osmane, që ishin vendosur në zonën e Milotit. Princit Skënderbeu i duhej të krijonte edhe rezerva ushqimore, prandaj quajt që kishte ngarkuar me grurë nga rruga e gjatë e Dibrës, i shkarkoi në këtë vendpushimi dhe ngriti një mulli në përroin e quajtur "udhraz". Ky u quajt mulliri "Fal", meqë e ngriti vetë Skënderbeu e ia dhuroi kësaj krahine, si mulli i të gjithëve, ku kishin e kanë të drejtë të bluajnë "kush shkon i pari, sipas radhës dhe falë". Mirëmbajtja e këtij mulliri, sipas zakonit, organizohej nga fshati me kontributin e të gjithëve.


Pra, i nderuar lexues, ky është mulliri, që "u zbulua" para disa muajsh nga një grup gazetarësh, të cilët bënë edhe një reportazh dhe nje montazh televiziv, duke e quajtur "zbulim të madh"! Arsyeto vetë i dashur lexues ...

Siç thotë historia, Skënderbeu, pasi i bëri këtë të mirë kësaj zone, mori rrugën Urdhraz e u ndal te konaku i Kok Malçit në Skuraj të Krujës. Kok Malçi, i sugjeroi princit që ushtrinë turke ishte mirë ta sulmonte në kohën e vapës, sepse atëhere ushtarët "bënin plazh" në lumin Mat, aty ku sot ndodhet ura e Zogut. Ai bëri këtë sugjerim pasi huqi i taboreve turke ishte që në kohë pushimi, armatimin e grumbullonin në formë kopuje dhe ishin të pakujdesshëm. Skënderbeu ashtu bëri dhe doli fitimtar. Miqësia e Skënderbeut me të mënçurin Malçi vazhdoi gjatë, saqë në krahinat e malësisë, princi zgjidhte edhe shumë probleme zakonore. Ja ç'tregon historia. Pasi mbaroi kuvendi i burrave, sipas zakonit, i zoti i shtëpisë do të shpërblente kuvendarët për opingat (që quhej koha e harxhuar e pleqërisë), pra para kuvendarëve si shpërblim nxorri një cjap të madh e një viç të vogël. Malçi i la radhën princit që të zgjedhte. Skënderbeu mori cjamin e madh. Por, Malçi atë e quajti jo mençuri. Skënderbeu e kundërshtoi për madhësinë e cjamin, por i mençuri Malçi e përballoi duke e argumentuar "cjap sot e cjam mot, kurse ky, viç sot, mëzat nesër e ka pasnesër". Skënderbeu e përgëzoi Malçin, duke e uruar "sa qofsh pleqërofs".

Edhe sot e kësaj dite, shtëpia e Malçit në Skuraj të Krujës, njihet si shtëpia e parë e pleqësisë së Kurbinit. Grupi i pleqve kuvendarë të Kurbinit, gjykon me urtësi e mençuri dhe ndikon për mirë në zgjidhjen e problemeve që hasin banorët e zonës. Dhe, mendojmë, se të ruash historinë, të ruash traditat e bukura, është kulturë dhe të ndihmon të ecësh përpara. Por, ja që ndodh edhe ndryshe. Mali i Skënderbeut "ka renë në hall të madh". "Sulmet" ndaj tij s'kanë të ndalur. Sulmet ndaj malit/pyllit vijnë nga tre fronte: Nga një anë sulmon Kruja, sulmi i dytë vjen nga Burreli dhe sulmi më ri e më i fuqishëm, është ai perëndimor, që vjen nga katundi i vjetër i Kurbinit, nga Laçi. Fuqia dhe egërsia e tij, përveç sëpatës shkatërruese, qëndron në faktin se laçianët mbajnë fort çertifikatën e pronësisë, të firmosur e vulosur nga Kuvendi Popullor, që nga drejtuesit e para 30-40 vjetëve e deri tek të sotmit. Me këtë rast, shrohet pyetja: Kush e ka këtë të drejtë që të çenojë e ndryshojë historinë?

Prandaj, Mali i Skënderbeut e pret pranverën e palulëzuar e, si të thuash, pa famë, se shtatin ia kanë zhveshur dhe vazhdojnë t'i heqin edhe filizat e rinj. E, çka është më e keqja, as vaj i qyqes nuk dëgjohet më, se ajo s'ka ku të qëndrojë; atë e përzenë zhurmat e borive nëpër rrugët gjarpërushe pyjore. Pra, këtij kreshniku nuk i ka mbetur tjetër, veç të kundërsulmojë me armën e erozionit, duke rrokullisur shkëmbenjt nga shtati i tij, ashtu siç bënte qëmoti kundër turqve, por sot i duhet "të sulmojë" veten. Do të shkatërrtojë kroin, do të prishë mullirin e, së fundi, "nga inati" do të shkatërrtojë konakun e plakut Malçaj dhe historinë tone të lashtë!

Le të shërbejnë këto dy fjalë, si apel, lutje, për të mbrojtur vlerat historike të Malit e vetë Krujës së Skënderbeut.



Vlerësimi i ndikimit të fushës elektromagnetike të antenave të telefonisë celulare mbi bimësinë pyjore

Dr. ELVINTOROMANI
Fakulteti i Shkencave Pyjore, Tiranë

Në vend të hyrjes

Revolucioni në teknologjinë e informacionit dhe transmetimit, ka përfshirë edhe vendin tonë. Kështu, në këtë kuadër, telefonia celulare sot ka gjetur një përhapje mjaft të madhe. Në mjaft kodra e male shikohen një numër i madh antenash të kësaj telefonie, që krijojnë rreth tyre një fushë elektromagnetike të fuqishme, e cila ndikon në bimësinë pyjore në një rreze të gjerë veprimi. Për rrjedhojë, dëmet e shkaktuara nga kjo fushë elektromagnetike në rritjen e bimësisë pyjore janë të shumëllojshme e të mëdha.


Në vende të ndryshme të botës janë kryer një sërë studimesh, me qëllim përcaktimin e ndikimit të fushës elektromagnetike në organizmat e gjalla (njerëz, bimë, kafshë, etj.), ndërsa tek ne nuk janë kryer studime të kësaj natyre.

Disa njohuri për fushën elektromagnetike

Bimët janë të ekspozuara në shumëllojshmëri stresesh, të shkaktuara nga faktorë abiotikë dhe biotikë, si: thatësira, shirat, streset termike, era, kontaktet mekanike dhe infektimet nga patogjenët. Por, në mjaft raste bimësia pyjore është e ekspozuar ndaj rrezatimit elektromagnetik, duke qënë nën presionin e kësaj fushe, veprimi i së cilës shkakton ndikime të shumta, që shpesh frenojnë rritjen e bimësisë pyjore.

Në përgjithësi, antenat e telefonisë celulare janë të tipit helikal dhe fuqia rrezatuese e tyre varet nga karakteristikat dimensionale. Fusha elektromagnetike e këtyre antenave ndikon mbi bimësinë pyjore nëpërmjet: Gjatësisë së valës ose ngjyrës, intensitetit dhe fotoperiodizmit (kohëzgjatjes në 24 orë).

Rrezatimi elektromagnetik ose drita, është një formë energjie, e cila ka dy komponentë: Elektrik (E) dhe magnetik (H).




Rrezatimi elektromagnetik karakterizohet nga: Gjatësia e valës (λ) dhe amplituda (A).

Produkti midis gjatësisë së valës (λ) dhe frekuencës (f) është konstant:

$$\lambda \cdot f = c$$

ku: c) shpejtësia e dritës ($3 \cdot 10^8$) m/s.

Rrezatimi elektromagnetik klasifikohet sipas gjatësisë së valëve, të cilat përbëjnë të ashtuquajturin spektër elektromagnetik. Madhësia e gjatësisë së valëve është nga një fraksion i nanometrit në disa kilometra (shih figurën).



Spektri elektromagnetik i rrezatimit

Siç shihet edhe nga figura, drita e dukshme me gjatësi vale 380-760 nm (nanometër) është esenciale për fotosintezën dhe për disa procese që kontrollojnë rritjen dhe zhvillimin e bimëve. Rrezatimi infrarred, me gjatësi vale 760-1 000 000nm, identifikohet si nxehtësi dhe shkakton rritje të temperaturës së bimëve. Nëse parametrat e mësipërm, që ndikojnë në rritjen e bimëve, janë në nivele normale, pavarësisht nga burimi rrezatues, ato nuk frenojnë rritjen e bimësisë pyjore. Por, këtu lind problemi, pasi bimësia pyjore që ndodhet pranë antenave të telefonisë celulare, përveç energjisë së rrezatimit diellor ndodhet edhe nën ndikimin e fushës elektromagnetike të antenave, duke bërë që intensiteti i kësaj fushe (i përbërë nga energjia diellore dhe fusha e induktuar nga antenat) të jetë më i madh se nivelet normale, duke ndikuar në frenimin e rritjes së bimësisë pyjorë. Kështu, telefonat celularë operojnë në frekuenca 824-849 MHz dhe, natyrisht, rëndësi ka edhe fuqia e prodhuar nga transmetuesi (antena) dhe distanca e organizmave të gjalla nga këta transmetues. Për të përcaktuar sasinë e energjisë së rrezatimit të frekuencave të antenave të telefonisë celulare përdoret parametri sasior SAR (niveli specifik i thithjes). Ky tregues përfaqëson sasinë e rrezatimit të thithur nga organizmi (bimor, shtazor apo human) në një rajon të lokalizuar ose në inde, shprehur në njësi matëse Wat/kg të indeve.

2. Llojet e dëmtimeve të shkaktuara nga fusha elektromagnetike

Shumica e spektrit elektromagnetik është e dëmshme për shëndetin. Fusha elektromagnetike jonatyrare dëmton fushën bio-magnetike të organizmit të gjallë, brenda së cilës gjenden miliona impulse elektromagnetike, që rregullojnë aktivitetin e çdo qelize. Nga studimet e bëra mbi sasinë e energjisë elektrike e magnetike që emetohet nga linjat e tensionit të lartë, antenat e telefonisë celulare apo burime të tjera, del se organizmat e gjalla sot marrin rreth 200 milionë herë më shumë rrezatim sesa të parët tanë. Nivelet e larta të fushës elektromagnetike shkaktojnë dëmtime në shëndetin e njeriut, si dhe mbi bimësinë. Rrezatimi elektromagnetik shkakton këto dëmtime në shëndetin e njeriut:

- Ç'rregullon kalueshmërinë e barrierave të gjakut në tru. Kjo barrierë është mekanizmi special mbrojtës i trupit që parandalon substancat e huaja të hyjnë në tru.
- Shkakton sëmundje në shumfishimin qelizor, duke ndryshuar sjellien e qelizave, indeve, organeve dhe organizmave.
- Ndryshon ciklet biologjike, duke prishur funksionet motorike.
- Shkakton ndryshime në nivelin e hormoneve, si në përmbajtjen kimike, qelizore dhe në sistemin imunitar.
- Shkakton dëmtime kromozomale dhe sterilitet (defekte e anomali në zhvillimin embrional). Rrit shkallën e vdekshmërisë, shkakton dështime të shtatzanisë.
- Shkakton probleme në sy dhe në damarë.
- Shkakton luhatje të memories, pasi një fushë elektromagnetike pulsuese shkakton çlirim të adrenalinës brenda 15 minutave.
- Rrit shkallën kancerogjene gjatë ndarjes qelizore.
- Shkakton leuçemi dhe kancere të tjerë (Qeveria Suedeze, për nga rreziku, fushën elektromagnetike e rendit pas duhanit dhe e konsideron kancerogjen të klasit të dytë.

Disa nga dëmtimet e shkaktuara nga veprimi i fushës elektromagnetike mbi rritjen e bimësisë pyjore janë:

- Ngacmime të membranave qelizore. Rreziku kryesor i fushës elektromagnetike në bimë është shoku elektrik, i cili rrit ngacmimin e membranave qelizore. Ky shok shkatohet si rezultat i induktimit me sipërfaqen e bimëve (gjetheve e kërcellit).
- Efekte termike të indeve. Ekspozimi në nivele të larta i fushës elektromagnetike shkakton edhe rritje të nxehtësisë së indeve dhe djegie të tyre. Natyrisht ky dëmtim varet nga mekanizmat termo-rregullatorë të bimëve, niveli i aktivitetit, kushtet mjedisore.
- Deformime të farave gjatë ripërtëritjes natyrore. Efekti i fushës magnetike është evidentuar edhe në fara gjatë ripërtëritjes natyrore të sipërfaqes pyjore. Fillimisht ky deformim nuk duket, por më vonë bëhet evident.
- Mutacionet e ADN. Ekspozimi në fushë elektromagnetike shkakton mutacione (ose alterime në sekuencat e ADN) duke koduar gjenet dhe proteinat.
- Ndikime në ritmin e rritjes së bimëve. Studimet kanë treguar se ndikimi i fushës elektromagnetike shoqërohet me ulje të ritmit të rritjes së bimësisë, e cila manifestohet edhe me humbje të sasisë së akumuluar të lëndës drusore.

Nisur nga këto ndikime, që fusha elektromagnetike ushtron mbi rritjen e bimësisë pyjore përreth antenave transmetuese dhe në organizmat e tjerë të gjallë, është mirë që të vlerësohet ky ndikim dhe humbjet që ai shkakton në rritjen e bimësisë pyjore. Pasi të kryhet ky vlerësim, nëse del se ndikimi është esencjal për rritjen e bimësisë dhe organizmave të tjerë të gjallë, është mirë që këto antena të vendosen në zona ku bimësia është e pakët, duke minimizuar efektin negativ të fushës elektromagnetike. Ky vlerësim do t'u shërbente organeve të administrimit të pasurisë pyjore që të rrisin tarifat e qirave dhe të kërkojnë dëmshpërblime nga kompanitë e telefonive celulare. Në një shoqëri të emancipuar kush dëmton duhet të paguajë për dëmin e shkaktuar dhe, në këtë rast, janë kompanitë e telefonisë celulare ato që duhet të paguajnë.

GORA KËRKON PYLLIN

Vijon nga fq. 2

e lumit e deri në majën e tij. Na rroftë neve që ruajmë fundin kur rrokullima e gjërave fillon nga maja. Ne, thonë ata, jem gati ta mbrojmë pyllin, por duam që të na e kuptoni hallin dhe ligji t'i shërbejë pyllit dhe jetës sonë. Çfarë fiton shteti që na pret majën e malit, e pas kësaj na jep investime e projekte që të rregullojmë fundin. E duam me ligj të gjithë malin, pasi ata që vijnë me makina e motosharra për të prerë, e kanë justifikimin në majë të gjuhës. Po presin në pyllin e shtetit, atë që po bëjnë edhe firmat private që kanë fituar me tender dhe presin Rrobullin e Strelcës. Kjo prerje masive e viteve të fundit, që po zhduk edhe drurët e farës, i tremb banorët e Gorës.

Nëse Berati i ka shkatërruar pothuaj tërë pyjet, puna atje ndryshon, ata kanë fushën, e fusha nuk të len pa bukë. Ndërsa

nëse në Gorë priten edhe drurët e farës, pas kësaj e vetmja pasuri që u mbetet këtyre malësorëve është blegtoaria. E keqja është se delet e dhitë nuk e lenë të ripërterihet pylli dhe për pak vite vjen shkretimi. Kështu mund të ketë ndodhur edhe me kodrat e Beratit në kohë të lashta. Të shumtët këtë nuk e besojnë. Për ta, faktorët që e kanë bërë shkretimin janë përbërja flishore e tokës, reshjet e shumta e rrebeshet në dimër, që zgjerojnë prroskat e mbathin tokat, bimësia e varfër, pjerrësia e madhe e tokës etj. Edhe për më të diturit është vështirë të besojnë se në ato shpate teresisht të gërryera e të shpëllara të ketë patur ndonjëherë pyje.

Jeta e një gjenerate njerëzore është e shkurter. Brenda kufijve të një jetë njeriu është vështirë të vesh re ndryshimet që ndodhin brenda kësaj periudhe, kur ti jeton brenda tyre. Hapi i kohës është ndryshe për një gjenerate njerëzore dhe ndryshe për jeten e një grumbulli pyjor. Moshë 300 vjeçare e një pylli i korrespondon një gjenerate njerëzore që arrin në 70 vjeç. Në

një zhvillim normal ne duhet ta lëmë botën përafërsisht ashtu siç e kemi gjetur kur kemi lindur. Ndryshimet radikale, si ato që shohim, dhe prerjet masive të trembin për fatin e brezit të ardhshëm. Banorëve të shkretëtirave, panorama e zymtë që i rrethon u duket e natyrshme dhe që ka qenë e tillë gjithmonë, gjersa gërmimet arkeologjike, apo zbulime të ndyshme të mos u tregojnë të kundërtën, si psh pushtues që shkatërrojnë të parat burimet natyrore e më pas edhe kasollet. Kështu thotë historia ndodhi me pyllin e Rrënjës, një lis i gjatë e i bukur, më i bukur në Evropë, me dru të mrekullueshëm, e gjithë fusha, nga Shkodra deri në Vlorë, që u pre tërësisht nga romakët për ndërtim anijesh, apo me pyllin e famshëm të frashërit, nga Mamurrasi deri në Fushë Krujë, që u pre në Luftën e Dytë Botërore. Kështu ka ndodhur edhe me pyjet e Beratit, dikur, herët, por gjyshërit e ata pas tyre nuk e mbajnë mend.

Pas Gorës fshihen dy fjalë në shqip: Mal e Pyll. Banoret e kësaj krahine

jetojnë në mal e pyll dhe janë pjesë e të dyve. Nëse banorëve të Beratit shteti u privatizoi tokën bujqësore, ata kërkojnë të fitojnë këtë të drejtë për tokën e tyre, me një fjalë pyllin e kullotën. Dhe kanë rreth 600 km², afërsisht një të pesëdhjetën pjesë të vendit tonë. Nëse zëri i tyre dëgjohej, ne mund të kemi më shume male të veshur me pyje.

Gora mund të bëhet shkollë e zhvillimit të qendrueshëm të malësive tona, pasi ka dëshirën dhe dijen.

Prandaj i duhet dhenë pylli Gorës.



THE INTERNATIONAL WORKSHOP “Sharing knowledge on Participatory Mapping for Forest and Pasture Areas -Combining different mapping techniques to address policy challenges in the management and use of forest and pasture lands”

Objectives

(i) Exchange knowledge among participants on practices and methodologies to mapping users' rights in rural areas, with a specific focus on forest and pasture lands.

(ii) Increase the understanding of the methodological challenges as related to the policy context in replicating/scaling up local innovative solutions to mapping users' rights, with a specific reference to the Albanian context.

(iii) Contribute to the international debate on the potentialities of mapping as a tool for participatory land rights' registration.

Participants

The Workshop will bring together experiences from Nicaragua, Indonesia and Bolivia, and is intended to give participants an overview of the tools, issues and applications of participatory mapping. In the Workshop will participate also the main stakeholders from the central institution and donors of Albania as well as representatives of Private Forest Owner Association from Kosovo and Macedonia.

Albanian context

Since 1995 the GoA with support of World Bank and other donors, based on the implementation of policies for the transfer of natural resource to local government and decentralization of their management, has supported the transfer of user rights and management of forest and pastures from the State to local communities. This new approach to natural resources management is beginning to reverse natural resource degradation in an area about 500,000 ha of forest and pastures. Experience from this project has shown that poverty reduction and sustainable natural resources management can go hand in hand when communities are provided with the right incentives. The established Forest and Pasture Users Associations (FPUAs) have developed and implemented management plans and have invested their membership dues into resource improvement activities.

In 2004 the regional federations of Dibra, Kukesi and Korca met and decided that they required representation at the national level to promote the interest of their members: in 2005 the National Association of Communal Forest and Pasture of Albania (NACFPA) was established. In the frame of the FPUAs and regional federation support on the tenure security of forest and pasture transferred in use to rural communities, NACFPA, with ILC support, undertakes the pilot project “*Enhancing tenure security through support the communities to improve the laws on Transfer of State Public Property (forest and pasture) to the communes*”.

The pilot project aims to enhance tenure security and property rights in forest and pasture land, in accord with traditional patterns along community and villages and to spread and enhance rights to profit or benefit from sustainable use of pasture or forestry resources.

The overall objective of the pilot project is to prepare clear guidelines and criteria on fixing and demarcating boundaries between state owned forest and communal forest in participatory way and to share the rights and responsibilities between them, guiding the local government and forest service in the same time how to resolve border disputes between state and communes, neighboring communes and villages.

CONCRETE STEPS IN ACHIEVING THE STRATEGY OF FORESTS AND PASTURES DEVELOPMENT

Eng. VLASHLEGISI, Chairman of
the Administration-Management
Department in FSD Mirditë

In the framework of the implementation of the Natural Resources Development Project (NRDP) a very good work was carried out this year in the local units of Rubik, Rreshen, Kaçinar and Orosh, where awareness for communal forests was raised. In the meetings held in the communes concerning the presentation of steps that will be followed in the drafting or reviewing of

The Sofia Consultation



As a consequence of the developments in 2006 the Global Fire Monitoring Center (GFMC) prepared and convened the “Regional Wildland Fire Consultation on the Development of a Strategy on International Cooperation in Wildland Fire Management in the Regional South East European / Caucasus Wildland Fire Network”.

The consultation was held between 19 and 21 March 2007 in Sofia, Bulgaria, under the umbrella of the UNISDR Wildland Fire Advisory Group / Global Wildland Fire Network through its Coordinator and Secretariat, the GFMC. The consultation was kindly supported and hosted by the National Forestry Board, Ministry of Agriculture and Forests, Bulgaria. The consultation included two days of meeting in Sofia and one day study to visit fire management establishments and measures taken in fire management in Bulgaria

The participating countries included Albania, Armenia, Bulgaria, Bosnia and Herzegovina, Croatia, Georgia, Hungary, Macedonia, Serbia, Slovenia, Romania, Turkey and Ukraine.

The main aim of the meeting was to seek inputs from participants of the invited countries to discuss and revise the initial draft of the regional strategy

paper, which had been developed by the coordinators of the Regional South-east Europe/Caucasus Wildland Fire Network and the Global Wildland Fire Network (Global Fire Monitoring Center), sponsored by the

German Foreign Office, and presented to the 33rd Session of the FAO European Forestry Commission (Zvolen, Slovakia, 25 May 2006).

In order to obtain a realistic picture of the fire situation in the region, all represented countries has prepared national country report, which include a self-assessment of the fire management capabilities and the definition for the need of action and international cooperation.

The Draft Regional Strategy

The draft “Regional Wildland Fire Consultation on the Development of a Strategy on International Cooperation in Wildland Fire Management in the Regional South East European/Caucasus Wildland Fire Network” was reviewed and discussed with inputs by all participants.

This strategy will serve as initial basis for discussion, application or implementation at various levels, e.g.

- Submission to government authorities in the participating countries as a basis for national development of capacities, or initiatives to developed with at bilateral levels (agreements between neighbouring countries), or multilaterally (at regional level);
- Submission to government agencies and the international

donor community to encourage the development of projects and programmes in capacity building and cooperation in fire management, preferably to be implemented at multinational / regional levels;

Conclusions and Recommendations

The organizers, hosts and participants of the regional consultation agreed that the meeting was a success in bringing together representatives of countries in a region where forest fires and wildland fires are playing an increasing role in the degradation of the natural environment and affecting human health and security. The participants are confident that bilateral and multilateral cooperation in fire management and cooperation with those sectors that are affecting fire incidence and impacts, or vice-versa, are being effected by fire, need to be addressed with priority. Border-crossing collaboration in fire prevention, capacity building and in suppression of fire disasters will be essential for making these visions reality.

The participants of the meeting expressed gratitude to the Global Fire Monitoring Center (GFMC) and GFMC's financial sponsors of the UNISDR Global Wildland Fire Network, as well as the coordinator of the UNISDR Regional Southeast Europe / Caucasus Wildland Fire Network for conducting the consultation, as well as the National Forestry Board, Ministry of Agriculture and Forests of Bulgaria, Sofia, for the logistical preparation and organization of the consultation.

management plans, besides the technical consultants, other well-known specialists have brought their expertise as Thimaq Lako, Arsen Proko, Haki Kola, Janaq Male, etc. Meanwhile, the consultant for the preparation of the management plans in some communes of Mirdita, “Diava Consulting” company, with its technical supervisor Eng. Abdulla Diku, has prepared and distributed

for every family a considerable number of leaflets where the focus are the benefits of communal forests, steps in achieving the management plans with the participation of local communities, etc. Thus, besides the extended meetings in communes with the participation from all villages, the informing and awareness for the communal forests and pastures with the support of NRDP is aimed

to go to family and users' levels. Certainly, such a campaign has given its results; presently the process has a wider participation. It is becoming known to all the ones interested in communal forests and pastures. “Diava Consulting” stresses an entire informing and sensitizing campaign at village and users' levels, something that was missing before.

KURORA E GJELBËR

Botim i Shoqatës Kombëtare të Pyjeve Komunalë, Tiranë

Kryeredaktor: AHMET OSJA

Zv.kryeredaktor: FERDIN LIÇAJ

Redaksia: Z. Ymeraj, M. Kotro, H. Kola, A. Postoli, Th. Lako, Gj. Fierza E. Kullaj, R. Hymetllari, A. Mehmeti, Y. Metaj, R. Ndreu, V. Hoxha
Art designer: V. Hoxha

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë

Mobile: 068 23 23 360; 069 21 11 333; 068 21 42 098

e-mail: kurora_gjelber@yahoo.com
velihoxha@yahoo.com



The International Land Coalition is a global alliance of intergovernmental, governmental and civil-society organizations. The Coalition works together with the rural poor to increase their secure access to natural resources, especially land, and to enable them to participate directly in policy and decision-making processes that affect their livelihoods at local, national, regional and international levels.



Connecting People's Capacities

